



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 119, dt. 25.05.2016

Në mbështetje të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 25.05.2016, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratohet projekti “Rikonstrukcion i trotuarit, ndriçimit dhe riveshje me shtresa asfaltike, te rruga “Antipatrea”, segmenti Ura e Varur – Ura e Goricës”, Berat, me këto vërejtje:
 - Fragmenti i trotuarit nga Xhamia e Beqarëve deri tek Lundra (krahu i lagjes Mangalem) të ruhet dhe të restaurohet,
 - Të unifikohen parkmakët e sheshit pranë Urës së Varur me parkmakët e trotuarit sipas vendimit të mëparshëm të KKR, nr.95, dt.01.06.2015.
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI